




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Tenderët me poentim të çmimit – mundësi për keqpërdorim



Tenderët me poentim të çmimit – mundësi për keqpërdorim

Autor: **Agon Hysaj**

Korrik 2021

Ky raport është përgatitur nga Demokracia Plus (D+) dhe mbështetur nga USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Procedura e poentimit të çmimit është një procedurë e cila përdoret në prokurimin publik për rastet kur autoriteti kontraktues “nuk e di” sasinë e artikujve që do të porosisë, dhe për këtë qëllim secili artikull në listë të çmimeve e ka sasinë “1”. Gjatë zbatimit të kontratës porositë bëhen varësisht prej nevojave që dalin. Lista e çmimeve ndahet në disa kategori dhe secilës prej tyre iu jepet një peshë e caktuar në totalin prej 100%. Poentimi i çmimeve shërben vetëm për të vlerësuar ofertat, ndërsa kontrata zbatohet me çmimet për njësi.

Më 28 janar 2021, përmes procedurës së poentimit të çmimit, Komuna e Prizrenit ka lidhur kontratë me konsorciumin “Eurovia & Daut Gashi B.I.” për tenderin “Furnizim me zhavorr për rrugët e paasfaltuara në Komunën e Prizrenit”. Çmim për njësi është lidhur në vlerën prej 16.48 euro. Kontrata është e tipit kontratë kornizë për 36 muaj. Vlera e parashikuar e tenderit ka qenë 1.5 milionë euro. E veçanta e kësaj procedure është se nuk mund të përdoret kufizimi prej plus/minus 30% i vlerës së kontratës, por kontrata realizohet për aq sa ka mjete të parashikuara për këtë tender. Rregullat për kontratën kornizë nuk specifikojnë minimumin e porosive që duhet të bëhen, që nënkupton se jodomsdoshmërisht do të shpenzohen të gjitha mjetet e parashikuara.

Në këtë kontratë çmimi i poentuar është 2.96 euro, ndërsa çmimi i papoentuar është 16.48 euro. Vlera shumë e ulët e çmimit të poentuar dhe atij të papoentuar në një tender 1.5 milionë euro tregon shumë për këtë aktivitet prokurimi. Kur ka dallim të madh në çmimin e poentuar dhe atë të papoentuar, çmimet për njësi janë shumë të ulëta. Pasi në tenderët me çmim të poentuar sasinë e artikujve janë “1”, atëherë kjo i mundëson kompanive që të japin çmime të ulëta në pozicionet që mendojnë që nuk do të porositen dhe çmime të larta në pozicione që mendojnë që do të porositen. Prandaj çmimi më i ulët i peshuar nuk do të thotë patjetër që do të jetë oferta me çmimin më të lirë. Krahasuar me tenderët e zakonshëm, të papoentuar, ku sasinë janë të dhëna për secilin artikull, atëherë operatori ekonomik duhet të japë për afërsisht çmime të tregut, pasi secili pozicion duhet të porositet.

Konsorciumi fitues, nga 30 pozicione në paramasë, në 19 prej tyre ka dhënë çmim 0.04 euro. Disa nga artikujt që kanë këtë çmim janë:

- Furnizim me gypa betoni (10 pozicione);
- Transporti i makinerive të nevojshme për kryerjen e punimeve (eskavator, buldozer, etj.);
- Hapja dhe pastrimi i kanalave atmosferike dhe transporti i dheut deri në deponi
- Furnizim me beton C25/30.

Disa pozicione kanë gjithashtu çmime shumë të ulëta në raport me çmimet e tregut:

- Furnizim me gur të thyer (apo zhavorr) (pesë pozicione) – 0.24 euro për m³;
- Gërmimi dhe planifikimi i rrugëve – 0.24 euro për m³.

Nga 30 pozicione, vetëm tre prej tyre kanë çmim më të lartë se 1 euro. Komuna nuk ka kërkuar sqarime për kompaninë se si ka mundësi që të realizohet kontrata me këto çmime. Kur ka çmime jonormalisht të ulëta, linden edhe dyshimet për keqpërdorime. Nuk është e pritshme që një kompani e cila ka për synim profitin, të ofertojë me çmime jonormalisht të ulëta dhe kështu të operojë me humbje. Në tenderët me poentim institucionet kanë mundësinë që një produkt mos ta porosisin fare. Pikërisht kjo është pika ku operatorët ekonomik mendojnë që do të kenë përfitim. Ata ofertojnë me çmime shumë të ulëta në pozicionet për të cilat mendojnë që nuk do të porositen, dhe çmime të larta në ato pozicione që mendojnë se do të porositen më shumë. Sigurisht që ky është një rrezik për kompanitë pasi ka mundësi që parashikimi i tyre të jetë i gabuar, dhe autoriteti kontraktues të porosisë produktet që kanë çmime jonormalisht të ulëta. Mirëpo, kompanitë tentojnë që të kenë informacion nga brenda

për të ditur se cilat pozicione do të porositen. Vetëm gjatë zbatimit të kontratës mund kuptohet se a kanë bashkëpunuar operatorët ekonomik me komunën.

Që nga lidhja e kontratës e deri më 8 korrik 2021, Komuna e Prizrenit ka paguar dy fatura në vlerë prej 99,998.45 euro (njëra faturë 50,868.45 euro, kurse tjetra 49,130 euro). Në lidhje me faturën e parë, komuna ka bërë porosi që të realizohen punime në katër rrugë të ndryshme. Porositë janë bërë për lloje të ndryshme të zhavorrit (çmimi 0.24 euro për m³), transporti i tyre (8.02 euro për m³) dhe shtruarja, planifikim dhe ngjeshja e gurit të thyer (1.18 euro për m³). Zakonisht këto tri pozicione në kontrata të institucioneve tjera janë të bashkuara në një pozicion të vetëm. Formën si e ka ndërtuar paramasën komuna, bën që nëse porositet ndonjë lloj i zhavorrit nga pozicioni A1 deri A5, atëherë duhet patjetër të porositet edhe transporti (C4) dhe shtruarja dhe ngjeshja (C6). Megjithatë, shprehja në pozicionet A1-A5 "Furnizim me gur të thyer" në gjuhën biznesore nënkupton edhe transportin. Ndarja në pozicione të veçanta ka bërë që në pamje të parë tenderi të shihet që ka çmime jonormalisht të ulëta. Mirëpo, kur mblidhen çmimet e tri pozicioneve më lartë del që komuna ka paguar çmim shumë të lartë për këtë shërbim:

- A3 – Furnizim me gurë të thyer Fr. 0-31.5 mm – 0.24 euro për m³
- C4 – Transporti i materialeve deri të vendi i caktuar – 8.02 euro për m³
- C6 – Shtruarja, planifikimi dhe ngjeshja e gurit të thyer deri në masën e ngjeshmërisë së kërkuar – 1.18 euro për m³

Të tri pozicionet së bashku kanë çmim 9.44 euro për m³. D+ ka shikuar disa kontrata në institucione tjera, ku çmimet janë dukshëm më të ulëta:

- [Komuna e Shtimes](#) në tenderin "Rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavorr" për pozicionin "Furnizimi dhe punimi i tamponit (60MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=15cm" ka paguar **2 euro për m³**
- [Komuna e Vushtrrisë](#) në tenderin "Ndërtimi i rrugës së rendit të katërt me zhavorr" për pozicionin "Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-60 mm me trashësi t=15cm" ka paguar **3 euro për m³**.
- [Komuna e Lipjanit](#) në tenderin "Asfaltimi i rrugicave në Konjuh dhe zhavorrimi i rrugës në Branesh" për pozicionin "Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5 mm" ka paguar **4 euro për m³**.
- [Komuna e Lipjanit](#) në tenderin "Zhavorrimi i rrugëve të kategorisë së katërt në Komunën e Lipjanit" për pozicionin "Furnizimi, planifikimi dhe ngjeshja e materialit guror me diametër 0-31.5 mm" ka paguar **3.67 euro për m³**.
- [Komuna e Fushë Kosovës](#) në tenderin "Furnizim me zhavorr për shtruarjen e rrugëve" për pozicionin "Furnizim me zhavorr me diametër 0.31, shtrirja me grejder dhe ngjeshja me cilindër 10-12 ton" ka paguar **3.75 euro për m³**.

Të gjitha shembujt më lartë në katër komuna të ndryshme, tregojnë se kanë paguar 2 deri në 4 euro për shërbimin e njëjtë që Komuna e Prizrenit e ka paguar 9.24 euro. Në pesë rastet më lartë përshkrimi i punës është i njëjtë: "të bëhet furnizimi, planifikimi, bartja dhe ngjeshja e gurit të thyer". Komuna e Prizrenit përmes kësaj kontrate do të paguajë gati tre herë më shumë krahasuar me komunat tjera, e sidomos kur vlera e kontratës është për rreth 15 herë më e lartë se e katër komunave tjera. Për rastet kur vlera e tenderit është më e lartë, edhe çmimi për njësi do të duhej të ishte më i ulët për shkak të sasisë së madhe që do të porositet.

Për faturën e dytë, Komuna e Prizrenit ka paguar 49,131.50 euro. Një pjesë të faturës, për punime të realizuara në rrugën "TA në drejtim të Arbëria Petrol – Pjesa e I-rë", komuna është faturuar 21,450.12 euro. Mirëpo, kjo shumë është faturuar vetëm për transport të materialeve (C4) dhe pastrim të terrenit (C5). Pra komuna ka paguar për transport, ndërsa nuk është

furnizuar me zhavorr. Pozicioni për transport është në kategorinë C të paramasës i cili ka përshkrimin “Shërbime me zhavorr”. Kjo nënkupton që transporti vlen vetëm për zhavorr.

TA SH.P.K.
 Nr. 34.2000. Prizren
 imzfi.com

e pa asfaltuara në Komunën e Prizrenit

	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH	TVSH-ja 18 %	Çmimi njësi me TVSH	Totali pa TVSH	TVSH	Totali me TVSH-€
	m ³	1.0	0.20	18.00	0.24	0.20	0.04	0.24
	m ³	1.0	0.20	18.00	0.24	0.20	0.04	0.24
	m ³	1.0	0.20	18.00	0.24	0.20	0.04	0.24
	m ³	1.0	0.20	18.00	0.24	0.20	0.04	0.24
	m ³	1.0	0.20	18.00	0.24	0.20	0.04	0.24

	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH	TVSH-ja 18 %	Çmimi njësi me TVSH	Totali pa TVSH	TVSH	Totali me TVSH-€
	m ¹	1.0	0.03	18.00	0.04	0.03	0.01	0.04
	m ¹	1.0	0.03	18.00	0.04	0.03	0.01	0.04
	m ¹	1.0	0.03	18.00	0.04	0.03	0.01	0.04
	m ¹	1.0	0.03	18.00	0.04	0.03	0.01	0.04
	m ¹	1.0	0.03	18.00	0.04	0.03	0.01	0.04

Punimet e realizuara nga TA ne drejtim te Arberia Petrolit pjesa I-rë (a)

Punimet nga data 08-13.04.2021		Data: 20.05.2021
Sasia e realizuar	Çmimi njësi me TVSH	Totali me TVSH-€
0.00	0.24	0.00
0.00	0.24	0.00
0.00	0.24	0.00
0.00	0.24	0.00
0.00	0.24	0.00
TOTALI ME TVSH A :		

Sasia e realizuar	Çmimi njësi me TVSH	Totali me TVSH-€
0.00	0.04	0.00
0.00	0.04	0.00
0.00	0.04	0.00
0.00	0.04	0.00
0.00	0.04	0.00

Figura 1: Situacioni i shërbimeve të porositura për punët e realizuara nga “TA në drejtim të Arbëria Petrol”. Sasia e porositur për furnizim me zhavorr është 0.00

Në një pjesë tjetër të faturës, për punime të realizuara në Krushë të Vogël, Vlashne dhe lëshesa në rrugën Muradem, komuna ka paguar 3,984.20 euro. Komuna ka porositur 88 m³ furnizim me zhavorr, ndërsa në anën tjetër transporti është faturuar për 446 m³ zhavorr. Në këtë situacion nuk ka asnjë produkt tjetër që është porositur e që ka nevojë për transport. Këtë e dëshmon pozicioni C6 që është për shtruarje dhe ngjeshje të zhavorrit me sasi 88 m³. Pikërisht pozicioni më i shtrenjtë në paramasë është paguar më shumë se sa sasia reale. Komuna ka paguar 3,576.92 euro, ndërsa është dashur të paguajë 705.76 euro (88 * 8.02), dhe i ka shkaktuar dëm buxhetit 2,871.16 euro.

Dyshimi që kur përdoret procedura me poentim të çmimit ka mundësi më të mëdha që të ketë keqpërdorime, vërtetohen përmes këtyre dy faturave. Në vetëm dy pjesë të faturës, furnizimi me zhavorr nuk është porositur fare e kjo ka mundur të ndodhë për shkak të çmimit shumë të ulët (0.24 euro), ndërsa në një tjetër, është rritur sasia për pozicionin që ka çmimin më të lartë. Komuna e Prizrenit, në vetëm rreth 6.7% të realizimit të kontratës, ka dëmtuar buxhetin e saj për 24,321.28 euro.

Për të evituar mundësinë për keqpërdorime, Komuna e Prizrenit, duhet që në të ardhmen të mos përdorë procedurën me poentim të çmimit. Aty ku është e mundur, të parashikohet sasia e produkteve që nevojiten për realizimin e punimeve. Pikërisht në këtë tender ka qenë e mundur që të jepet një sasi indikative të produkteve dhe pastaj të mund të përdoret kufiri prej plus 30% në rast që komuna do të kishte nevojë për furnizime shtesë. Kjo do të pamundësonte

që një pozicion me çmime të shtrenjtë të faturohet tërë kohën dhe kontrata do të ndërpritej automatikisht nëse do të ishte tejkaluar kufiri prej plus 30%.





USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

